




REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
GJYKATA KUSHTETUESE

# Buletini periodik i Gjykatës Kushtetuese

*Vendimet janar-shkurt 2024*



Buletini periodik i vendimmarrjes

Nr. 1 , janar-shkurt 2024

© Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Ky botim u mundësua me kontributin e Konferedatës Zvicerane, në kuadër të Projektit “Rritja e transparencës dhe aksesit në drejtësinë kushtetuese”



## HYRJE

*Në kuadër të komunikimit të vazhdueshëm me publikun dhe median, të garantimit të transparencës, si dhe të rritjes së aksesit në Gjykatën Kushtetuese, si një nga parimet më të rëndësishme dhe thelbësore të administrimit të drejtësisë, Gjykata publikon për herë të parë Buletinin Periodik të vendimmarrjes së saj. Ky buletin paraqet një përmbledhje të çështjeve të shqyrtuara nga Gjykata për të cilat është dhënë vendim gjatë periudhës janar-shkurt 2024.*

*Si një risi në veprimtarinë e Gjykatës, botimi i Buletinit Periodik ka si qëllim informimin dhe njohjen e praktikantëve të së drejtës, studiuesve të ligjit, e çdo lexuesi, me vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese, dhe me qëndrimet e mbajtura prej saj. Kështu, botimi i sjell vendimet në mënyrë të përmbledhur dhe me një gjuhë lehtësisht të kuptueshme për lexuesin. Për secilën prej tyre, paraqiten faktet që lidhen me çështjen konkrete, vlerësimi i Gjykatës lidhur me pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe vendimmarrja e mënyra e votimit.*

*Në këtë numër të parë do të gjeni të gjitha vendimet përfundimtare të dhëna gjatë periudhës në fjalë, si dhe disa vendime të përzgjedhura të Mbledhjes së Gjyqtarëve.*

## PËRMBAJTJA

Kontroll i akteve normative	4
Gjykim incidental	8
Ankim kushtetues individual	10
Vendime të Mbledhjes së Gjyqtarëve për ankimin kushtetues individual	18

**E drejta për arsim—  
E drejta për punë –  
Parimi i sigurisë  
juridike**

## **FJALË KYÇE**

**Studentë të mjekësisë/  
kosto e studimeve/  
marrëveshje/ trajtim i  
veçantë/ diplomë/ shlyerje  
e detyrimit për punësim/  
punësim me prioritet**

Parashikimet ligjore që përcaktojnë se studentët, në rast të nënshkrimit të marrëveshjes, nuk kanë të drejtë të pajisen me diplomë, e cila kalohet nga institucioni i arsimit të lartë në institucionin shëndetësor ku do të punësohen dhe lëshohet vetëm me “shlyerjen e detyrimeve për punësim”, kanë përcaktuar detyrime dhe rregulla të reja, të cilat ata nuk i kanë njohur dhe as nuk i kanë pranuar më parë, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike. Formula e përzgjedhur ndërhyrës edhe në të drejtën kushtetuese për të pranuar dhe zgjedhur vetë vendin e punës, në kuptim të nenit 49 të Kushtetutës, për sa kohë që vullneti i studentëve për të siguruar mjetet e jetesës me punë të zgjedhur ose të pranuar vetë është i vesuar. Kjo ndërhyrje nuk plotëson kriterin e proporcionalitetit, pasi nuk është e përshtatshme në lidhje me urgjencën e ndërhyrjes legislative në drejtim të efekteve të pritshme të saj.

## **Një grup deputetësh të Kuvendit dhe një grup studentësh të Fakultetit të Mjekësisë (ligji i studentëve të mjekësisë) - vendimi nr. 1, datë 25.01.2024**

### *Faktet*

Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 60/2023 “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë”. Ky ligj ka parashikuar mekanizmin përmes të cilit studentëve që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë u ofrohet një trajtim i veçantë, i cili, përfshin punësimin pas përfundimit të studimeve kur pranojnë të nënshkruajnë marrëveshje me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik. Sipas marrëveshjes, studenti duhet të punojë në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për, respektivisht, jo më pak se pesë vjet, tre vjet dhe dy vjet në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, që nënkupton kalimin zyrtarisht të diplomës nga institucioni publik në institucionin shëndetësor ku punësohet deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim” sipas këtyre afateve. Studenti që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshjen paguan vlerën e plotë të koston së studimeve. Kërkuesit kundërshtuan këto parashikime ligjore si të papajtueshme me Kushtetutën.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*E drejta për arsim e lidhur me parimin e sigurisë juridike* - Dispozitat e kundërshtuara të ligjit kanë ndryshuar situatën ligjore të studentëve të mjekësisë në këto drejtime: (i) vendosja para zgjedhjes për nënshkrimin e një marrëveshjeje për punësim; (ii) në rast të nënshkrimit të marrëveshjes studenti nuk pajiset me diplomë, e cila mbahet nga institucioni shëndetësor ku ai punësohet dhe lëshohet pas “shlyerjes së detyrimeve për punësim”; (iii) në rast të mosnënshkrimit të marrëveshjes paguhet kosto e plotë e studimeve. Këto ndryshime përbëjnë një përkeqësim të situatës ligjore të studentëve të mjekësisë, si të atyre të ndërmjetëm, ashtu edhe të studentëve që hyjnë rishtazi në Fakultetin e Mjekësisë, të cilët nuk janë njohur me këtë situatë dhe nuk e kanë pranuar atë në momentin që kanë vendosur të konkurrojnë pranë atij fakulteti. Përkeqësimi i situatës ligjore të studentëve, duke parashikuar detyrime dhe rregulla të reja, të cilat ata nuk i kanë njohur dhe as nuk i kanë pranuar më parë, nuk përputhet me parimin e sigurisë juridike

*E drejta për punë* - Dispozitat e kundërshtuara, në pjesën që parashikojnë afatet për punësim pas përfundimit të studimeve, sjellin kufizim të së drejtës kushtetuese të studentëve për të zgjedhur vendin e punës. Në kuptim të testit të proporcionalitetit, skema e zgjedhur është më e ashpër sesa ishte e nevojshme për arritjen e qëllimit të synuar në raport me rrethanat që e kanë diktuar atë. Detyrimi i studentëve për të zgjedhur mes nënshkrimit ose jo të marrëveshjes, me pasojën që në rast të nënshkrimit diploma kalohet zyrtarisht në institucionin shëndetësor ku punësohen deri në “shlyerjen e detyrimeve për punësim”, ka çuar në mohim tërësor të së drejtës për të zgjedhur vendin e punës, sipas kushteve dhe kriterëve me të cilat studentët janë njohur dhe i kanë pranuar në momentin që kanë nisur studimet apo kanë konkurruar për këtë qëllim.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, me shumicë votash, pranimin pjesërisht të kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim pjesërisht kundër).

## Shqyrtimi i marrëveshjes ndërkombëtare para ratifikimit – Marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me territorin dhe të drejtat dhe liritë e njeriut (të migrantëve) – Autorizimi për lëshimin e plotfuqisë për negociim dhe nënshkrim

### FJALË KYÇE

*Negocim/ ratifikim/ territor/ aspekti fizik dhe juridiksional i territorit/ të drejtat e migrantëve/ plotfuqi/ flukse migratore/ vende të treta/ zona pa kundërshtim*

Protokolli për Migracionin nuk ka parashikuar rregulla që passjellin efekte mbi tërësinë territoriale të Republikës së Shqipërisë në favor të shtetit italian dhe as nuk përmban ndonjë parashikim për heqjen dorë të shtetit shqiptar nga ushtrimi i juridiksionit mbi territorin e tij. Ushtrimi i juridiksionit të shtetit italian është përcaktuar për zbatimin e detyrimeve të atij shteti në lidhje me migracionin dhe azilin në kuadër të garantimit të të drejtave të migrantëve që burojnë nga e drejta ndërkombëtare. Nga ana tjetër, për shkak të pozicionit që zë Protokolli në hierarkinë e akteve juridike, ai nuk përjashton juridiksionin e shtetit shqiptar në nivel kushtetues dhe konventor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ndonëse është një marrëveshje ndërkombëtare që ratifikohet me ligj nga Kuvendi, Protokolli nuk përfshihet në kategorinë e atyre të parashikuara nga neni 121, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të Kushtetutës, ndaj autorizimi për lëshimin e plotëfuqive për negociimin e nënshkrimit e tij i takon Qeverisë (Kryeministrit).

## Një grup deputetësh të Kuvendit (*Protokolli me Italinë*) – vendimi nr. 2, datë 29.01.2024

### Faktet

Ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë është nënshkruar në vitin 2023 Protokolli “Për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”. Ai ka pasur qëllim menaxhimin e flukseve migratore nga vendet e treta, ku pala shqiptare i njeh palës italiane të drejtën e përdorimit të dy zonave pa kundërshtim nga 5 vite deri në 10 vite. Në këto zona, pala italiane mund të krijojë struktura për pritjen e migrantëve dhe numri i tyre nuk mund të jetë më i lartë se 3000 veta. Ato do të menaxhohen nga autoritetet italiane, sipas legjislacionit italian dhe evropian dhe mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet tyre dhe migrantëve, do t’i nënshtrohen ekskluzivisht juridiksionit italian.

### Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata, referuar natyrës së pretendimeve, shqyrtoi Protokollin për Migracionin në tre aspekte: (i) nëse ai përbën marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë me territorin e shtetit shqiptar, në kuptim të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 121 të Kushtetutës; (ii) nëse ai përbën marrëveshje ndërkombëtare që ka të bëjë me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në kuptim të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 121 të Kushtetutës; për rrjedhojë (iii) nëse autorizimi i dhënë nga Kryeministri për lëshimin e plotëfuqisë për grupin negociator dhe nënshkrimi prej vetë atij përmbushin kërkesat kushtetuese për negociimin dhe nënshkrimin e këtij akti. Ky vlerësim i jep përgjigje më pas, nëse ai cenon të drejtat dhe liritë themelore të të huajve (migrantëve), të garantuara nga Kushtetuta dhe e drejta ndërkombëtare e detyrueshme për zbatim nga Republika e Shqipërisë.

Gjykata, për sa i takon shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 121, të Kushtetutës, vlerësoi se Protokolli për Migracionin, në aspektin fizik të territorit, nuk përcakton apo ndryshon integritetin territorial të Republikës së Shqipërisë, pasi, në thelb, nuk ndryshon apo cakton kufij të saj, duke ruajtur në këtë mënyrë të paprekura të gjitha elementet e territorit në aspektin fizik; dhe në aspektin juridiksional të territorit, ai nuk ndryshon juridiksionin territorial të shtetit shqiptar në lidhje me Kushtetutën, KEDNJ-në dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; shteti shqiptar vazhdon të ushtrojë juridiksionin e tij edhe gjatë kohës që akti do të jetë i zbatueshëm; ai lejon që në një pjesë të territorit shqiptar, krahas juridiksionit shqiptar, të ushtrohet edhe juridiksioni i autoriteteve italiane ekskluzivisht për çështjet e azilit. Gjykata çmoi se Protokolli për Migracionin është një marrëveshje dypalëshe për ndarjen e detyrave midis autoriteteve shqiptare dhe atyre italiane për çështjet e migrantëve dhe nëngrupit të azilkërkuarve, që synon të shmangë një vakuim juridiksional dhe përgjegjësish për të drejtat dhe liritë themelore të tyre, ndaj kalimi i juridiksionit autoriteteve italiane për çështjet e migrantëve dhe azilkërkuarve ka qenë i nevojshëm.

Për sa i takon shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 121 të Kushtetutës, Gjykata vlerësoi se Protokolli për Migracionin nuk krijon të drejta dhe liri themelore të reja kushtetuese dhe as nuk sjell kufizime shtesë në të drejtat dhe liritë ekzistuese të njeriut, përtej atyre që parashikohen nga rendi juridik shqiptar. Kryeministri ka autoritetin për dhënien e autorizimit për lëshimin e plotëfuqisë për negociimin dhe nënshkrimin prej atij vetë të Protokollit për Migracionin, mbështetur edhe në Traktatin e Miqësisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës Italiane dhe Republikës së Shqipërisë i vitit 1995, i cili bazuar në neni 180 të Kushtetutës, përbën një marrëveshje kuadër, e cila shërben si bazë e mjaftueshme që Protokolli për Migracionin të nënshkruhet nga Qeveria.

Protokolli për Migracionin, ndonëse është marrëveshje ndërkombëtare që ratifikohet me ligj nga Kuvendi, nuk përfshihet në kategorinë e atyre marrëveshjeve ndërkombëtare të parashikuara nga neni 121, pika 1, shkronja “a” dhe “b”, të Kushtetutës, dhe për këtë shkak autorizimi për lëshimin e plotëfuqive për negociimin e nënshkrimit e tij i takon Qeverisë (Kryeministrit).

### Vendimmarrja

Gjykata vendosi, me shumicë votash, deklarin e Protokollit në pajtim me Kushtetutën dhe lejimin e ratifikimit të tij nga Kuvendi (katër gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

### **E drejta për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij**

#### **FJALË KYÇE**

**Mjedis/ gjendja e mjedisit dhe mbrojtja e tij/ mjedis i shëndetshëm/ shqetësime mjedisore/ konsultim publik/ projekte me impakt në mjedis/ Konventa e Aarhus-it/ direktivë/ identitet kombëtar/ objektiva sociale/ akt individual/ liria e veprimtarisë ekonomike**

Mosrealizimi i procesit të konsultimit publik të ligjit nr. 38/2021 gjatë fazës së miratimit të tij ka vesuar këtë procedurë, për sa kohë që nuk është garantuar pjesëmarrja e publikut në fazën e parë të projektimit dhe ndërtimit të projektit të HEC-it të Skavicës, sipas parashikimeve të nenit 56 të Kushtetutës dhe neneve 6 dhe 8 të Konventës së Aarhusit, të cilat përcaktojnë detyrimin e shtetit për të informuar dhe garantuar pjesëmarrjen efektive të publikut në veprimtari që mund të sjellin pasoja në mjedis. Megjithatë, edhe në fazën në të cilën projekti ndodhet aktualisht, ekziston mundësia e përfshirjes së publikut për të realizuar ushtrimin efektiv të së drejtës së tij për të marrë informacion për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij, si një premisë për të garantuar një proces të drejtë e transparent vendimmarrës nga ana e autoriteteve publike.

### **Shoqata “Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës”, Shoqata “Për Mbrojtjen e Pronave dhe Mjedisit të Pellgut të Drinit të Zi”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (çështja e Skavicës) – vendimi nr. 3, datë 30.01.2024**

#### **Faktet**

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 38/2021 për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Sipas këtij ligji, kontrata për realizimin e këtij projekti ndahet në dy faza, ku faza e parë përfshin aktivitetet paraprake të punës që do t'i mundësojnë shoqërisë të paraqesë një propozim tek autoriteti kontraktues për kontratën e fazës së dytë, e cila konsiston në projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Kërkeset (grup shoqatash) kanë pretenduar se ndërtimi i HEC-it të Skavicës cenon një sërë të drejtash dhe lirish kushtetuese.

#### **Vlerësimi i Gjykatës**

*E drejta për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij* – Organet shtetërore kanë cenuar të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, ndonëse aktet ndërkombëtare parashikojnë detyrimin për informimin e publikut përgjatë gjithë procesit. Procedura e miratimit të ligjit nr. 38/2021 është zhvilluar pa konsultime publike, pa u dëgjuar opinioni i komunitetit të zonës, me statusin e publikut të ndikuar, si dhe pa u bërë vlerësimi i ndikimit të projektit në mjedis dhe në të drejta të tjera të lidhura me të. Megjithatë, duke pasur parasysh se projekti ndodhet ende në fazën e parë të zbatimit, në përputhje me detyrimet që përcaktojnë neni 56 i Kushtetutës dhe Konventa e Aarhusit, shkeljet e konstatuara gjatë fazës përpara miratimit të ligjit mund të riparohen ende përmes përfshirjes së publikut në veprimtari dhe informacione që lidhen me fazat e ndryshme në vijim të zhvillimit dhe zbatimit të projektit, si dhe në vendimmarrje. Përpara ndërmarrjes së nismave me impakt në mjedis dhe në të drejta të tjera themelore të lidhura me të që në fazat e hershme të projektit shteti ka detyrimin të informojë publikun, në veçanti publikun e ndikuar, për hapat që do të ndërmerren; t'i japë atij mundësinë të njihet me studimet e kryera dhe raportet e hartuara, gjetjet në lidhje me efektet e mundshme të projektit, masat e parashikuara për pakësimin e këtyre efekteve, vendimmarrjen në lidhje me projektin dhe arsyet mbi të cilat është bazuar kjo vendimmarrje, si dhe të paraqesë komente, informacione, analiza ose opinione që i konsideron të vlefshme.

#### **Vendimmarrja**

Gjykata vendosi, njëzëri, konstatimin e shkeljes së të drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij në procedurat e miratimit të ligjit nr. 38/2021 dhe urdhërimin e autoriteteve publike për të riparuar shkeljen e konstatuar.

## Parimi i sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronës private dhe parimin e proporcionalitetit – Parimi i hierarkisë së akteve

**FJALË KYÇE**  
*Pronë private/  
shpronësim/ zë kadastral/  
zbatim i detyrueshëm i  
vendimeve të Gjykatës  
Kushtetuese dhe GJEDNJ-  
së*

Edhe pse ligji ka kufizuar të drejtën e subjekteve për të përfituar indeksim nuk ka përkeqësuar gjendjen e tyre. Për periudhën nga momenti i publikimit deri kur vendimi i kompensimit bëhet i ekzekutueshëm, subjekteve u kalon barra për plotësimin e dokumentacionit për ushtrimin e së drejtës për përfitim të kompensimit financiar. Për periudhën nga momenti që vendimi bëhet përfundimtar dhe i ekzekutueshëm dhe shteti ngarkohet me detyrimin për zbatimin e tij, subjektet përfitojnë indeksim sipas interesit bankar deri në momentin e ekzekutimit. Indeksi sipas inflacionit përbën garancinë minimale dhe, nga ana tjetër, shteti nuk zhvishet nga detyrimi që të përgjigjet për vonesat e mëparshme të shkaktuara ndaj subjekteve. Rezultati i testimit të zbatimit të të gjitha varianteve të formulave të parashikuara nga ligji sipas kufijve të formulës së parashikuar në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, provoi se përmbushen detyrimet e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, ndaj nuk ka cenim të së drejtës së pronës.

## Komuniteti Mysliman i Shqipërisë (*Ligji i Pronave*) – vendimi nr. 5, datë 13.02.2024

### *Faktet*

Në vitin 2015 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”. Ligji i Pronave dhe aktet nënligjore në zbatim të tij i janë nënshtruar kontrollit kushtetues dhe Gjykata është shprehur me vendimet nr. 1, datë 16.01.2017 dhe nr. 4, datë 15.02.2021. Në vitin 2022 Kuvendi ka miratuar ligjin nr. 77/2022, i cili ka sjellë disa ndryshime në Ligjin e Pronave, dhe në vijim, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM-në nr. 313/2023 i cili ka sjellë disa ndryshime në VKM-në nr. 223/2016 që ka të bëjë me përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave. Këto akte janë kundërshtuar në Gjykatë nga kërkuesi duke pretenduar se cenojnë të drejta dhe parime kushtetuese.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*Parimi i sigurisë juridike në lidhje me të drejtën e pronës private dhe parimin e proporcionalitetit* – Ndryshimi i periudhës së indeksimit për efekt të inflacionit, përmes zëvendësimit të fjalëve “marrja e shpërblimit” me fjalët “datën e publikimit” është bërë me ligj, për një interes publik dhe nuk ka cenuar parimin e proporcionalitetit. Ndryshimet e nenit 7 të ligjit nuk rezultojnë në kundërshtim me vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *Beshiri dhe të tjerë k. Shqipërisë* dhe vendimin nr. 4/2021 të Gjykatës, për sa i përket respektimit të pragut minimal prej 10% të vlerës së përgjithshme të pronës, të vlerësuar sipas zërit kadastral aktual. Parashikimet e reja japin garanci akoma më të larta, pasi garantojnë një shpërblim më të lartë se sa pragu minimal prej 10%, duke e ruajtur 10%-shin si standard minimal të kompensimit të përcaktuar nga GJEDNJ-ja. Në rastin kur ndryshimi i zërit kadastral ka ndryshuar negativisht vlerën e pronës, ligjvënësi ka garantuar që, në rastet kur vlera e pronës në kohën e shpronësimit rezulton më e madhe se 10% e vlerës aktuale të saj, subjekti i shpronësuar të kompensohet me vlerën e llogaritur sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit, duke garantuar standardin minimal të vendosur nga GJEDNJ-ja.

*Parimi i hierarkisë së akteve* – Ndryshimet e bëra në VKM-në nr. 223/2016 janë bërë nga Këshilli i Ministrave duke vepruar brenda hapësirës së njohur atij nga Ligji i Pronave.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

**Legjitimimi i gjykatës referuese - Identifikimi i ligjit të zbatueshëm**



**FJALË KYÇE**  
**Përgjegjësi penale/ kompetencë lëndore/ përgjim ambiental/ gjyqtar a quo/ kritere kumulative**

## **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*kompetenca lëndore e gjykatës së posaçme*) - vendimi nr. 29, datë 14.02.2024 i Mbledhjes së Gjyqtarëve**

### *Faktet*

Çështja ka të bëjë me procesin e nisur para gjykatës referuese nga një shtetas, i cili ka kallëzuar penalisht, ndër të tjerë, edhe gjyqtarë e prokurorë të posaçëm për kryerjen e veprave penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Moskallëzimi i krimi”. Gjykata referuese ka vlerësuar se nenet 14 dhe 53 të ligjit nr. 95/2016 janë të papajtueshme me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, pasi përcaktojnë se gjyqtarët dhe prokurorët e posaçëm do të hetohen dhe gjykojnë nga Prokuroria e Posaçme dhe gjykatat e posaçme për vepra penale që i përkasin hetimit dhe gjykimin nga gjykatat e zakonshme.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

#### *Legjitimi i gjykatës referuese- kriteri i identifikimit të ligjit të zbatueshëm*

Gjykata referuese ka në shqyrtim çështjen e kallëzimit penal për kryerjen nga prokurorë dhe gjyqtarë të posaçëm të veprave penale të parashikuara nga nenet 186, 248 dhe 300 të KP-së, gjatë hetimit të çështjes penale në ngarkim të kallëzuesit për veprën penale të parashikuar nga neni 328 i KP-së, kompetente për shqyrtimin e së cilës, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, janë gjykatat e posaçme. Kallëzimi penal i këtij shtetasi nuk është bërë për shkak të cilësive të posaçme të gjyqtarëve dhe prokurorëve të kallëzuar, por për shkak të veprimeve a mosveprimeve të tyre në lidhje me procesin penal në ngarkim të tij, çka përfshihet në kompetencën e gjykatave të posaçme, sipas përcaktimeve të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 95/2016. Neni 53 i ligjit nr. 95/2016, që si qëllim ka raportimin e informacionit dhe të provave për një shkelje që ka të bëjë me kushtet e sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin të kryera nga zyrtarët e gjykatave të posaçme dhe SPAK-ut, si dhe nisjen, mbi bazën e këtij raporti, të hetimit ndaj këtyre zyrtarëve, nuk lidhet me shqyrtimin e çështjes që po gjykohej nga gjyqtari *a quo*. Neni 14 i ligjit nr. 95/2016 i kundërshtuar si antikushtetues nuk përcakton kompetencën lëndore të gjykatës referuese, ndaj nuk e pengon atë në shqyrtimin e çështjes përpara saj. Gjykata referuese nuk ka arritur të identifikojë ligjin e zbatueshëm dhe të përcaktojë lidhjen e drejtpërdrejtë reale dhe aktuale mes dispozitës të kundërshtuar si antikushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes për shqyrtim para saj.

### *Vendimmarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare (tre gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).





**Parimi i sigurisë juridike - E drejta për të mos u dënuar pa ligj – Parimi i proporcionalitetit – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

### **FJALË KYÇE**

***I mitur në konflikt me ligjin/ burgim i përjetshëm/ gjykim i shkurtuar/ interpretim unifikues apo njësues/ pritshmëri të ligjshme/ shkallë e katërt/ interpretim arbitrar***

Ekzistenca e dy vendimeve të ndryshme të Gjykatës së Lartë lidhur me zbatimin e gjykimit të shkurtuar në rastet e të miturve në konflikt me ligjin për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, nuk mund të passjellë pritshmëri të ligjshme për zbatimin e tij, për sa kohë nuk ka një interpretim unifikues apo njësues në këtë drejtim. Përfundimi i gjykatave se në rastin e kërkesit nuk mund të zbatohet gjykimi i shkurtuar është bërë duke interpretuar në mënyrë të integruar dispozitat e KPP-së dhe KDPM-së.

## **Florjan Gega (gjykim i shkurtuar në rastin e të miturit) - vendimi nr. 4, datë 31.01.2024**

### **Faktet**

Kërkuesi, i mitur në konflikt me ligjin, është akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja në rrethana cilësuese”, të parashikuar nga neni 79/1, shkronja “a”, i KP-së. Gjyqtari i seancës paraprake ka vendosur mospranimin e kërkesës së mbrojtësit të kërkesit për gjykim të shkurtuar, me arsyetimin se neni 403/2 i KPP-së ndalon gjykimin e shkurtuar për veprat penale si ajo për të cilën akuzohet kërkuesi, për të cilat parashikohet dënimi me burgim të përjetshëm. Çështja është gjykuar me gjykim të zakonshëm dhe kërkuesi është deklaruar fajtor dhe është dënuar me 12 vjet burgim. Gjykata e apelit ka gjetur të drejtë vendimin dhe i ka vlerësuar të pabazuara pretendimet për refuzimin e gjykimit të shkurtuar. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432/1 të KPP-së.

### **Vlerësimi i Gjykatës**

*Parimi i sigurisë juridike* - Ndonëse Gjykata e Lartë ka disponuar me dy vendime gjyqësore të dhëna në dy raste, në të cilat ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për zbatimin e gjykimit të shkurtuar në rastet e të miturve në konflikt me ligjin, kjo nuk mund të passjellë pritshmëri të ligjshme të kërkesit për zbatimin e tij, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues apo njësues në lidhje me të. Në kushtet kur nuk ka një vendim unifikues ose njësues për zbatimin e gjykimit të shkurtuar për të miturit në konflikt me ligjin për veprat penale që parashikojnë dënimin me burgim të përjetshëm, pritshmëritë e kërkesit për pranimin e kërkesës për zbatimin e gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Lartë janë të pabazuara.

*E drejta për të mos u dënuar pa ligj të lidhur me parimin e proporcionalitetit, në këndvështrim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* - Ndonëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arritur në përfundimin se gjykimi i shkurtuar nuk mund të zbatohet në gjykimin e çështjes së kërkesit, nuk rezultojnë interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë të ketë qenë arbitrar në nivelin që të mund të konsiderohet se kërkuesi është dënuar pa ligj ose në mënyrë joproporcionale.

### **Vendimmarrja**

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrezimin e kërkesës (tre gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

## E drejta për kohëzgjatje të arsyeshme të procedurave

### FJALË KYÇE

*E drejta e pronës private/pezuillim i procesit gjyqësor/ procedim penal/afati maksimal i kohëzgjatjes së hetimeve/zgjatja e afatit të hetimeve/viktimitë e veprës penale/perspektiva për përgjigje përfundimtare nga gjykata/ viktima e veprës penale*

Referuar afatit të arsyeshëm në hetimin e veprave penale sipas KPC-së dhe afatit maksimal të hetimeve sipas KPP-së, është e rëndësishme ushtrimi nga prokurori i përgjegjësishë për regjistrimin në regjistrin e njoftimit të veprave penale të emrit të personit që i atribuohet vepra penale. Kjo nuk nënkupton mundësinë e shmangies ose të neglizhencës në këtë drejtim, por një përgjegjësi të shtuar të tij në funksion të një hetimi objektiv, të drejtë, efektiv dhe efikas. Në kallëzimin penal kërkuesi ka identifikuar personat që, sipas tij, kanë kryer veprën penale dhe nisur nga fakti se hetimi paraprak vijon prej më shumë se 3 vjetësh, kohëzgjatja e tij nuk mund të klasifikohet si normale në kontekst të rrethanave të procedimit penal.

## *Erdi Prifti (kohëzgjatja e paarsyeshme në procedimin penal) - vendimi nr. 6, datë 15.02.2024*

### Faktet

Kërkuesi është palë paditëse në procesin gjyqësor civil, i cili është pezulluar me vendim të gjykatës deri në përfundimin e çështjes penale të vënë në lëvizje po nga kërkuesi, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, pika 1, i KP-së në lidhje me disa prova të paraqitura në gjykim nga pala e paditur. Duke qenë se procedimi penal nuk kishte përfunduar ende, kërkuesi ka paraqitur kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të hetimit, për sa kohë që ai është bërë pengesë për zhvillimin e procesit civil. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke vlerësuar se kërkuesi ndodhet në cilësinë e kallëzuesit/viktimitës së veprës penale në një çështje që ndodhet në fazën e hetimit, për rrjedhojë nuk përfshihet në parashikimet e nenit 6 të KEDNJ-së. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e cenimit.

### Vlerësimi i Gjykatës

#### *E drejta për kohëzgjatje të arsyeshme të procedurave*

Prokuroria nuk ka sjellë asnjë informacion për gjendjen e procedimit penal edhe pse kanë kaluar më shumë se 3 vjet nga regjistrimi i tij. Procedimi penal kapërcen tejzgjatjen normale të hetimit në kuptim të KPC-së, për pasojë çështja civile ku kërkuesi është palë vijon të jetë ende në shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë prej më shumë se 3 vjetësh. Bazuar në kriteret që përcaktojnë kohëzgjatjen e arsyeshme Gjykata vlerësoi: i) *Sjellja e kërkuesit* - Kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezultoi të ketë shkaktuar vonesa në proces. ii) *Kompleksiteti i çështjes* - Gjykata, në mungesë të informacionit nga prokuroria, nuk konstatoj që hetimi të shfaqë ndonjë kompleksitet kur bëhet fjalë për verifikimin e pretendimit për falsitet të dy akteve shkresore. iii) *Sjellja e autoriteteve* - Prokuroria, si organi kompetent për zhvillimin e hetimeve, nuk ka paraqitur prapësime në lidhje me pretendimet e kërkuesit. Në lidhje me procesin civil, perspektiva nuk duket shpresëdhënëse në pikëpamje të afërsisë kohore kur kërkuesi, në procesin civil, do të ketë një përgjigje përfundimtare për të drejtën subjektive të pretenduar. Gjykata që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit nuk ka bërë asnjë analizë në drejtim të legjitimitetit të kërkuesit në lidhje me të drejtat që vihen në diskutim dhe dëmin që mund t'i ketë ardhur në të drejtat ligjore që kërkon të mbrojë përmes asaj kërkesë. Për rrjedhojë ai vendim vë në dyshim edhe standardin e arsyetimit. iv) *Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuesi* - Kohëzgjatja e hetimeve dhe kohëzgjatja tërësore e procedurave merr rëndësi në drejtim të asaj që rrezikon kërkuesi qoftë si viktimitë e veprës penale, ashtu edhe si palë në procesin gjyqësor civil të pezulluar.

### Vendimmarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

**E drejta për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj**

### **FJALË KYÇE**

**Administratë doganore/  
pikë doganore/ masë  
disiplinore/ shërbim civil/  
barrë e provës/ ripërcaktim  
i fakteve/ vlerësim i  
ndryshëm i provave**

Nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit ka përcaktuar vetë faktet e çështjes në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkuesit dhe pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të tij dhe, mbi këtë bazë, ka zgjidhur në themel çështjen, çka do të thotë se ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave nga sa kishin arritur dy gjykatat e faktit.

## **Klodian Çani (largim nga shërbimi civil) - vendimi nr. 7, datë 20.02.2024**

### *Faktet*

Kërkuesi ka qenë i punësuar në administratën doganore. Pas informacionit të Drejtorisë së Hetimit pranë Departamentit Operativ Hetimor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “Për referimin e veprës penale të prokurorit” lidhur me veprimet dhe mosveprimet të personelit doganor të Degës së Doganës Kakavijë, fillimisht Komisioni Disiplinor ka vendosur pezullimin e kërkuesit nga detyra dhe më pas marrjen e masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil”. Kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi për shfuqizimin e vendimit, rikthimin në punë dhe pagimin e pagës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadsisë, vendim që është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Mbi bazën e rekursit të palës së paditur, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur ndryshimin e këtyre vendimeve dhe rrezimin e padsisë.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*E drejta për t`u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* - Gjykata e Lartë ka përcaktuar vetë faktet e çështjes në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkuesit dhe pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të tij dhe, mbi këtë bazë, ka zgjidhur në themel çështjen, duke bërë një vlerësim të ndryshëm të provave nga sa kishin arritur dy gjykatat e faktit, gjë e cila nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në atë gjykatë. Ajo gjykatë, vlerësimin se veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të detyrave funksionale e ka lidhur me efektin që ka në procesin administrativ vendimi i prokurorit për pushimin e procedimit penal, ndërkohë që gjykatat e faktit, edhe pse i janë referuar kësaj prove shkresore, e kanë lidhur atë me mungesën e të provuarit të faktit disiplinor dhe të pasojave të ardhura në atë rast, duke mbajtur në vëmendje se barra e provës në këtë drejtim rëndon mbi organin publik punëdhënës. Edhe pse Gjykata e Lartë është shprehur se gjykatat e faktit nuk kanë interpretuar dhe zbatuar drejt dispozitat e KPP-së, nuk ka evidentuar ndonjë fakt të pranuar si të provuar nga ato dhe, më tej, nuk ka dhënë kuptimin për interpretimin dhe zbatimin e ligjit material në raport me ndonjë detyrim kontraktual konkret të shkelur nga kërkuesi, si dhe ndonjë element konkret në të cilin është mbështetur në arritjen e përfundimit, pavarësisht se largimi nga shërbimi civil është masa më e ashpër ndaj duhet parë si alternativa e fundit për t`u përzgjedhur nga organi publik punëdhënës.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

## Parimi i prezumimit të pafajësisë – Parimi i barazisë së armëve - Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor

### FJALË KYÇE

*Mashtrim me sigurimet/  
pension invaliditeti/  
pension pleqërie si  
punëtor nëntoke/ pezullim  
i dënimit me kusht/  
karakteri i shkeljes  
procedurale/ krahasimi i  
të dhënave të  
dokumenteve*

Gjykata e apelit, edhe pse duhej të shqyrtonte çështjen në mënyrë të plotë nga pikëpamja e fakteve dhe e ligjit, nuk është ndalur në shqyrtimin dhe analizimin/vlerësimin e provave thelbësore që, sipas kërkuarit, provonin pafajësinë e tij. Mënyra se si ka vepruar gjykata e apelit në raport me pasojat e ardhura për kërkuarin, qoftë edhe duke mos arsyetuar se pse nuk duheshin marrë në konsideratë rrethanat dhe provat në favor të tij, vë në dyshim respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur një qëndrim konkret në lidhje me këtë pretendim, pavarësisht se është me natyrë kushtetuese dhe nuk është haptazi i pabazuar.

## Pjetër Gjoni (proces penal për mashtrim me sigurimet) - vendimi nr. 8, datë 20.02.2024

### Faktet

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër ka paraqitur kallëzim penal ndaj kërkuarit, duke pretenduar se ka përfutur padrejtësisht pension pleqërie pasi nuk plotësonte kushtet ligjore. Prokuroria ka nisur procedimin penal ndaj kërkuarit për veprën penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i KP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka vendosur deklarinim e pafajshëm të kërkuarit, pasi nuk provohet të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohej. Gjykata e Apelit Shkodër, pasi ka riçelur pjesërisht hetimin gjyqësor, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe dënimin e kërkuarit me 6 muaj burgim, si dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për një periudhë 2-vjeçare. Mbi rekursin e kërkuarit, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e tij pasi nuk përmbante shkaqe ligjore.

### Vlerësimi i Gjykatës

Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor – Gjykata e apelit, ndonëse e ngarkuar me ligj për të shqyrtuar çështjen në mënyrë të plotë nga pikëpamja e fakteve dhe e ligjit, nuk është ndalur në shqyrtimin dhe analizimin/vlerësimin e provave thelbësore të kërkuarit, që, sipas tij, provonin pafajësinë. Pavarësisht se ka arsyetuar se regjistri i ish-Ndërmarrjes Gjeologjike Shkodër në pjesën që i takon kërkuarit, është tërësisht i falsifikuar, ajo nuk ka argumentuar se nga kush është falsifikuar dhe se si ka arritur në këtë përfundim në lidhje me një dokument që është administruar nga vetë DRSSH-ja Shkodër. Ajo është mjaftuar të konsiderojë të falsifikuar këtë dokument për shkak të fshirjeve apo ndërhyrjeve dhe duke u bazuar në krahasimin e tij me të dhënat e regjistrit të ish-kooperativës bujqësore, por ka shmangur krahasimin me të dhënat e dokumenteve të tjera që nuk janë në harmoni me të apo edhe me të dhënat e dokumenteve të tjera që nuk duket se janë në kontradiktë me regjistrin (libreza e punës dhe vërtetimet e asistencës). Mënyra se si ka vepruar gjykata e apelit në raport me pasojat e ardhura për kërkuarin, qoftë edhe duke mos arsyetuar se pse nuk duhet të merren në konsideratë rrethanat dhe provat në favor të tij, vë në dyshim respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, ashtu edhe parimin e barazisë së armëve. Edhe pse pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është ngritur në rekurs dhe ka gjetur pasqyrim në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ai nuk ka mbajtur qëndrim, pavarësisht se pretendimi ka natyrë kushtetuese dhe nuk është haptazi i pabazuar.

### Vendimarrja

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

**E drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar – Parimi i sigurisë juridike – Standardi i arsytimit të vendimit – E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj – Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit**

### **FJALË KYÇE**

**Veprim absolutisht i pavlefshëm/fektivitet i kontratës/ vendim unifikues/ vendime diametralisht të kundërta/ barrë prove/ shqyrtim në dhomën e këshillimit**

Pavarësisht se gjykatat e faktit kanë arsyetuar në mënyrë diametralisht të kundërt në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, palët janë njoftuar rregullisht për zhvillimin e saj, u është dhënë mundësia të dëgjohej përmes paraqitjes së parashtrimeve dhe prapësimeve me shkrim dhe në përfundim Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje në themel shkaqeve të ngritura në rekurs. Edhe pse në Gjykatën e Lartë janë analizuar dy çështje ligjore për pavlefshmërinë absolute të kontratës, ato nuk janë diskutuar me nismë të saj për përbënin shkaqe të kërkesëpadisë dhe janë debatuar nga palët në të dyja shkallët e gjykimit dhe po ashtu rekursi kishte pretendime për mënyrën e interpretimit të ligjit në këtë drejtim. Ndonëse Gjykata e Lartë ka përmendur argumente të reja që nuk janë përmendur nga gjykata e apelit, ajo nuk ka bërë ripërcaktim të fakteve. Referimi në provat e administruara nga gjykatat më të ulëta është në funksion të dhënies së një vendimi të arsyetuar.

## **Albert Sino, Aurel Baçi (pavlefshmëri e kontratës së shitblerjes së aksioneve) - vendimi nr. 9, datë 27.02.2024**

### *Faktet*

Çështja ka të bëjë me shitjen e 60% të aksioneve të një shoqërie që vepron në fushën televizive nga themeluesi dhe ortakut i vetëm i shoqërisë të dy kërkuarit. Pasi themeluesi ka ndërruar jetë, trashëgimtarët ligjorë i janë drejtuar gjykatës për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, si i kryer pa marrë më parë pëlqimin e bashkëshortes dhe i kryer në kushtet e fktivitetit. Gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesëpadinë duke arsyetuar se kontrata përbën provë të plotë në lidhje me pronësinë e aksioneve të kërkuarve dhe nuk provohet ekzistenca e kundërdeklarimit për marrëveshjen e fshehtë ose kryerjen e këtij veprimi në kundërshtim me ligjin. Gjykata e apelit ka vendosur shfuqizimin e atij vendimi dhe pranimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se kontrata është një veprim juridik fktiv, i kryer për të plotësuar kriteret e nenit 20 të ligjit nr. 9742/2007 që kërkonte që asnjë subjekt në fushën e medias të mos zotëronte më shumë se 40% nga një person i vetëm; çmimet e shitjes ishin të pamundura për t'u paguar nga kërkuarët si dhe kjo pagesë nuk është e vërtetuar me asnjë dokument. Në vijim, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarve. Gjykata e Lartë ka arritur në përfundimin se kontrata ka qenë një veprim absolutisht i pavlefshëm, e lidhur në kushtet e fktivitetit.

### *Vlerësimi i Gjykatës*

*E drejta për t'u mbrojtur dhe për t'u dëgjuar* – Edhe pse përpara dy vendimeve diametralisht të kundërta, Gjykata e Lartë i ka njoftuar rregullisht palët dhe u ka kthyer përgjigje në themel pretendimeve të tyre. Gjithashtu ajo gjykatë nuk ka vënë në diskutim çështje të ligjit, për të cilat palët nuk kanë qenë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësinë të debatimit. Shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar.

*Parimi i sigurisë juridike i lidhur me standardin e arsytimit të vendimit* - Ndonëse kontrata përbënte forcën e ligjit, thelbi i gjykimit ka qenë vlefshmëria e saj. Ndërsa në lidhje me pretendimin se Gjykata e Lartë duhet t'i referohej një vendimi unifikues të Kolegjeve të Bashkuara, Gjykata vlerësoi se Gjykata e Lartë, edhe pse nuk i është referuar atij vendimi në zgjidhjen e çështjes konkrete, ajo ka zbatuar nenin 92/ç të KC-së, duke i dhënë kuptim përmbajtjes së tij lidhur me veprimin juridik fktiv. Ky interpretim i Gjykatës së Lartë nuk duket haptazi i paarsyeshëm.

*Parimi i gjykatës së caktuar me ligj* - Ndonëse në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka përmendur argumente të reja të cilat nuk janë përmendur nga gjykata e apelit, nuk rezultojnë që ajo të ketë bërë ripërcaktim të fakteve ose të ketë nxjerrë konkluzion të ndryshëm për të në raport me atë të gjykatës së apelit. Gjithashtu Gjykata e Lartë nuk ka zhvendosur barrë të tepruar prove në lidhje me fktivitetin e kontratës të kërkuarit (të paditurit në gjykim).

*Parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* - Kërkuarët nuk janë vënë në pozita të pabarabarta me palën paditëse dhe atyre u është dhënë mundësia të paraqesin pretendimet dhe provat e tyre.

### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër).

### **Liria personale - Parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues**

**FJALË KYÇE**  
*Liri personale/ ligj penal  
favorizues / kriteret e  
individualizimit të  
dënimit/ marzhe të  
dënimit*

Kolegji Penal ka vlerësuar se duhej të zbatohet ligji penal favorizues, por e ka konsideruar dënimin e dhënë për kërkuesin të përshtatshëm pasi nuk ka lonte limitin e parashikuar nga ligji i ri, pavarësisht se gjykatat e faktit kishin dhënë masë të ndërmjetme dënimi për njërin vepër dhe masë minimale dënimi për tjetrën. Caktimi i masës së dënimit në përputhje me marzhet e tij është çështje ligji ndaj Gjykata e Lartë duhej të kishte zbatuar vetë ligjin në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, duke individualizuar dënimin për secilën nga veprat për të cilat ishte dënuar kërkuesi dhe duke u siguruar që jo vetëm të mos ishte në kapërcim të masës së parashikuar nga ligji penal favorizues, por edhe në përputhje me kriteret e individualizimit të dënimit të aplikuar nga gjykata e faktit.

### ***Kujtim Kllogjeri (ligji penal favorizues me fuqi prapavepruese) - vendimi nr. 10, datë 28.02.2024***

#### *Faktet*

Kërkuesi, me detyrë administrator në një shoqëri ndërtuese është akuzuar për përvetësimin e pasurive të shumë personave në kushtet e mirëbesimit. Përmes veprimeve aktive të kundërligjshme, ai ka arritur të mashtrrojë edhe shumë të tjerë, të cilëve u ishin premtuar viza pune kundrejt pagesës. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur deklarinimin fajtor për veprat penale “Mashtrimi” me pasoja të rënda dhe “Mashtrimi” në dëm të disa personave, të parashikuara nga neni 143/2 të KP-së, duke e dënuar, në bashkim të dënimeve, me 12 vjet burgim. Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se nuk konstatohen shkelje të zbatueshmërisë së ligjit material favorizues, me pasojë rëndimin e pozitës së të gjykuarit.

#### *Vlerësimi i Gjykatës*

*E drejta për liri personale e lidhur me parimin e fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues* - Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 36/2017, paragrafi 2 i nenit 143 të KP-së ka ndryshuar, duke parashikuar masa më të ulëta dënimesh. Në kushtet kur shqyrtimi i çështjes së kërkuesit në Gjykatën e Lartë është kryer në kohën kur ligji penal favorizues kishte hyrë në fuqi, si dhe duke pasur parasysh se caktimi i masës së dënimit për kryerjen e një vepre penale në përputhje me marzhet e dënimit të parashikuara nga ligji për të është çështje ligji (jo fakti) ajo gjykatë duhej të kishte zbatuar vetë ligjin në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes, duke individualizuar dënimin për secilën nga veprat për të cilat është dënuar kërkuesi dhe duke u siguruar që dënimi i tij jo vetëm të mos ishte në kapërcim të masës së dënimit të parashikuar nga ligji penal favorizues, por edhe në përputhje me kriteret e individualizimit të dënimit të aplikuar nga gjykata e faktit.

#### *Vendimmarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

**E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm - Mjetet efektive për përshpejtimin e gjykimit – Mosshterim i mjeteve juridike**

**FJALË KYÇE:**  
*Marrëdhënie pune/ fleksibilitet/ formalizëm i tepruar/ kohëzgjatje tërësore/ mjet efektiv/ kujdes i duhur/ kërkesë formale/ mjete parandaluese dhe riparuese/ subsidiare*

Në kuptim të së drejtës për proces të rregullt mjeti efektiv për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave i përket gjykatave të zakonshme. Gjykata Kushtetuese investohet vetëm për riparimin e shkeljeve të kryera nga ato gjykata, në rast se nuk janë në gjendje të korrigojnë dhe riparojnë vetë shkeljen, pra kur mjeti juridik nuk ka qenë efektiv. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk konsiderohet si instrumenti normal që i paraprin kërkesës për dëmshtëpërlim dhe individ, përpara se të kërkojë shpërblimin e dëmit, duhet të përdorë në kohën e duhur mjetin juridik parandalues/ përshpejtues, në kuptim të dispozitave të KPC-së dhe parimit të subsidiaritit. Paraqitja formalisht e një kërkesë në Gjykatën e Lartë nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme në kuptim të shterimit të mjeteve juridike përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues.

### ***Ledina Mandija (kohëzgjatja e paarsyeshme e procesit në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë) - vendimi nr. 11, datë 28.02.2024***

#### ***Faktet***

Kërkuesja, e cila ka ushtruar fillimisht detyrën e Avokatit në Zyrën e Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit dhe më pas atë të Avokates së Shtetit në Zyrën e Këshillimit dhe të Koordinimit Ndërmintor, pas shkarkimit nga detyra i është drejtuar gjykatës me padi për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin të shkarkimit, rikthimin në detyrë dhe shpërblimin për pagat e papaguara. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë, vendim që është prishur nga Gjykata Administrative e Apelit, pasi janë lejuar shkelje të rënda procedurale, duke rikthyer çështjen në shkallë të parë. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë. Pas publikimit të njoftimit për datën e shqyrtimit të rekursit, kërkuesja ka paraqitur në atë gjykatë kërkesë për konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt për shkak të tejzgjatjes së gjykimit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur pushimin e shqyrtimit të kërkesës pasi çështja gjyqësore e kërkueses kishte përfunduar, për rrjedhojë, kërkesa kishte mbetur pa objekt. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar konstatimin e cenimit të së drejtës për një gjykim në një afat të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Lartë, si dhe mungesën e efektivitetit të mjeteve të reja juridike të parashikuara nga KPC-ja.

#### ***Vlerësimi i Gjykatës***

Gjatë kohës që çështja e kërkueses ndodhej në gjykatën e apelit, edhe pse kishte në dispozicion dy mjete juridike, ankimin kushtetues dhe kërkesën sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së, ajo nuk ka treguar kujdesin e duhur për ndërmarrjen e këtyre hapave proceduralë. Kërkesën në Gjykatën e Lartë kërkuesja e ka paraqitur vetëm pasi ishte publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate njoftimi për shqyrtimin e çështjes së saj në dhomën e këshillimit. Kjo kërkesë qartazi ka qenë formale dhe as vetë kërkuesja nuk duket se ka pasur ndonjë pritshmëri në drejtim të efektivitetit të saj lidhur me përshpejtimin e procesit, zhvillimi i të cilit tashmë ishte planifikuar. Paraqitja formalisht e një kërkesë në Gjykatën e Lartë nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme në kuptim të shterimit të mjeteve juridike përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues. Në rast se individ i shteron mjetet juridike në momentin dhe kohën e duhur, dhe, për më tepër, nëse nuk provon se këto mjete janë joefektive, kjo nuk nënkupton se ai mund të rivendoset në të drejtën për të ngritur pretendime në Gjykatë në përfundim të të gjithë procesit gjyqësor, për arsyeshmërinë e kohëzgjatjes tërësore të tij.

#### ***Vendimmarrja***

Gjykata vendosi, me shumicë votash, rrëzimin e kërkesës (një gjyqtar u shpreh me mendim kundër).



### **E drejta për ankim efektiv - E drejta për t'u mbrojtur- Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor**

#### **FJALË KYÇE:**

**Avokat i caktuar me  
prokurë nga familjarët/  
avokat i palegjitimuar/  
qëndrim formalist/  
interpretim i ngushtë/  
elemente formale të  
rekursit/ vullneti i të  
pandehurit**

Gjykata e Lartë, në përputhje me funksionin dhe pozicionin e saj, i ka të gjitha hapësirat që kërkesat ligjore për elementet formale të recursit t'i interpretojë me qëllim garantimin e së drejtës së aksesit substancial. Pavarësisht parashikimit të pikës 3 të nenit 48 të KPP-së, që lejon zgjedhjen e mbrojtësit nga një i afërm derisa personi nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, i interpretuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kjo e fundit nuk e ka trajtuar çështjen bazuar në këtë parashikim ligjor. Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar recursin e mbrojtësit të zgjedhur nga nëna e kërkuesit duke bërë një kontroll formal të prokurës, pa verifikuar nëse kjo zgjedhje ishte rezultat i vullnetit të plotë të kërkuesit.

### ***Kudret Barjamaj (rekursi i nënshkruar nga mbrojtësi me prokurë nga familjarët) – vendimi nr. 12, datë 28.02.2024***

#### *Faktet*

Kërkuesi është hetuar dhe gjykuar, sipas procedurës së gjykimit të zakonshëm, në masën e sigurimit “Arresti në burg” për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, e mbetur në tentativë, “Prishja e qetësisë publike”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79, shkronja “dh”, 274 dhe 278, paragrafi i 5-të, të KP-së. Gjatë gjykimit të gjykatën e rrethit dhe të apelit kërkuesi ka qenë i përfaqësuar fillimisht me avokat të zgjedhur dhe më pas me avokat të caktuar kryesisht. Rekursi në Gjykatën e Lartë është ushtruar nga avokati i caktuar me prokurë nga nëna e kërkuesit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e recursit, pasi ishte paraqitur nga një avokat i caktuar me prokurë nga nëna e kërkuesit, për rrjedhojë ai nuk legjitimohej. Kolegji Penal ka arsyetuar edhe se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

#### *Vlerësimi i Gjykatës*

*E drejta e aksesit e lidhur me ankimin efektiv dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* - Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim formalist dhe nuk ka bërë asnjë përpjekje për të verifikuar nëse zgjedhja e mbrojtësit nga nëna e kërkuesit ishte ose jo në përputhje me vullnetin e kërkuesit. Nga ana tjetër, referuar kërkesës në Gjykatë, rezultoi se vullneti i nënës së kërkuesit për zgjedhjen e një mbrojtësi për të përputhet me vullnetin e tij. Pavarësisht kësaj, Kolegji Penal e ka kapërcyer kriterin formal të pranueshmërisë së recursit, duke vënë në diskutim kriterin substancial, atë të parashtrimit në recurs të shkaqeve nga ato të parashikuara nga ligji procedural dhe, më tej, nëse ato ishin ose jo haptazi të pabazuara. Gjykata, nga përmbajtja e recursit, vëren se në të ishin parashtruar pretendime me natyrë kushtetuese, kryesisht në lidhje me cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur gjatë gjykimit në gjykatat e zakonshme dhe me individualizimin e dënimit. Në drejtim të së drejtës së mbrojtjes, Gjykata, nisur nga rrethanat e çështjes konkrete, evidenton rëndësinë dhe efektivitetin e saj për personin e gjykuar gjatë procesit gjyqësor penal dhe përgjegjshmërinë që duhet të ketë avokati i zgjedhur me vullnetin e personit, po ashtu edhe ai i caktuar kryesisht nga gjykata në realizimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

#### *Vendimarrja*

Gjykata vendosi, njëzëri, pranimin e kërkesës.

# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQATARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**E drejta e aksesit në gjykatë – Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor - Parimi i paanshmërisë në gjykim**

## *Anton Arapi - vendimi nr. 1, datë 09.01.2024*

### *Faktet*

Kërkuesi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 78-25, 78-25-22 dhe 278/2 të KP-së, duke u dënuar me burgim të përjetshëm. Ai ka paraqitur kërkesë për rishikim të vendimit të formës së prerë, për të cilën gjykata e shkallës së parë ka vendosur mospranimin, me arsyetimin se nuk i referohet asnjërës prej situatave të parashikuara në nenin 450, pika 1, të KPP-së për pasojë është e pabazuar në ligj. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikon neni 432 i KPP-së.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

*E drejta e aksesit në gjykatë e lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* – Vendimi i Gjykatës së Lartë, në tërësinë e tij, paraqitet i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe në unitet e harmoni me njëra-tjetrën, duke përjashtuar çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi i kufizuar i vendimit të Gjykatës së Lartë është në përputhje me standardet e Gjykatës për këto lloj vendimesh, duke përmbushur kriteret në drejtim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Po kështu, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e kërkuesit në lidhje me kërkesën e tij për rishikim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

*Parimi i paanshmërisë në gjykim* – Pretendimi për paanshmërinë e një prej gjyqtarëve të gjykatës së shkallës së parë është i pabazuar, sepse nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i justifikueshëm në këtë drejtim.

### *Vendimmarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, me shumicë votash, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare (dy gjyqtarë u shprehën me mendim kundër dhe një gjyqtar me mendim paralel).

**FJALË KYÇE**  
**Rishikim i vendimit gjyqësor të formës së prerë/ burgim i përjetshëm/ prova të reja**

# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**E drejta për proces të rregullt ligjor - Afati i arsyeshëm - Parimi i proporcionalitetit - Parimi i barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit**



**FJALË KYÇE**  
**Gjobë/ titull ekzekutiv/ abuzim me të drejtën për ankim kushtetues individual/ barrë e provës**

## ***Shoqëria “Elgakoti” sh.p.k., Bardhyl Ibra - vendimi nr. 5, datë 12.01.2024***

### *Faktet*

Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese ka caktuar ndaj kërkuesve gjobë në vlerën 100,000 lekë, për abuzim me të drejtën për të paraqitur kërkesë, dhe ngarkimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor për ekzekutimin e saj për llogari të buxhetit të shtetit. Zyra Përmbarimore ka filluar ekzekutimin e titullit ekzekutiv, ndaj kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për pezullimin e zbatimit të vendimit të gjobës të Mbledhjes së Gjyqtarëve, shpalljen e pavlefshmërisë së tij, si titull ekzekutiv, si dhe shfuqizimin si antikushtetuese të shprehjes në nenin 31/c, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

*Legjitimimi ratione personae dhe shterimi i mjeteve juridike* - Pretendimi për mosgjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm ka natyrë të përgjithshme dhe kërkuesit nuk kanë përcaktuar konkretisht se ndaj cilit gjykim ngrihet ai, edhe pse kanë barrën e provës në këtë drejtim. Megjithatë, kërkesat e paraqitura nga kërkuesit janë marrë në shqyrtim nga Gjykata brenda afatit ligjor 3-mujor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000. Në lidhje me pretendimet për titullin ekzekutiv, kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion të parashikuara nga legjisllacioni procedural për mbrojtjen kundër ekzekutimit të titullit ekzekutiv në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Në lidhje me kërkimin për shfuqizimin e dispozitës ligjore, rregullimi ligjor në nenin 31/c të ligjit nr. 8577/2000 është zbatuar drejtpërdrejt ndaj tyre.

*Legjitimimi ratione temporis* - Kërkesa është depozituar përmes shërbimit postar pas më shumë se 5 muajve nga dërgimi i vendimit të kundërshtuar. Kërkuesit nuk kanë parashtruar asnjë të dhënë dhe argument në funksion të të provuarit të faktit të paraqitjes së kërkesës në respektim të afatit ligjor. Kërkesa për shfuqizimin e përmbajtjes së dispozitës ligjore është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor.

### *Vendimmarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, njëzëri, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQ TARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor—  
E drejta e aksesit në gjykatë**

## *Erion Çerekja (ankesë ndaj magjistratit) - vendimi nr. 33, datë 22.02.2024*

### *Faktet*

Kërkuesi, palë paditëse në procesin gjyqësor, ka paraqitur ankesë në ILD për gjyqtarin që kishte shqyrtuar ankimin ndaj vendimit për rrëzimin e kërkesës për sekuestron konservative dhe për gjyqtarin që kishte shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e gjyqtares që gjykonte çështjen në themel. ILD-ja ka vendosur arkivimin e ankesës, vendim ndaj të cilit kërkuesi ka paraqitur ankim pranë KLGJ-së. Për këtë ankim KLGJ-ja ka vendosur refuzimin e ankimit. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e këtyre vendimeve.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

*Legjitimitimi ratione personae* - Procesi administrativ i vënë në lëvizje nga kërkuesi/ankuesi ka pasur në objektin e tij verifikimin e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit. Si i tillë, është një proces me rëndësi publike dhe nuk lidhet individualisht me të drejtat personale të individit. Për këtë të fundit, legjislacioni ka garantuar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të ILD-së në një organ *quasi gjyqësor*, siç është komisioni i posaçëm i krijuar pranë KLGJ-së, si një mjet transparence dhe për të rritur përgjegjshmërinë e organeve që administrojnë sistemin e drejtësisë. Pozicioni i individit si ankues në këtë procedurë nuk e kthen çështjen e përgjegjësisë personale të magjistratit në interes personal të kërkuesit. Po ashtu, në analizë të fundit, duhet theksuar se kërkuesi ka paraqitur ankesë në ILD për shkak të një procesi gjyqësor për të drejtën e pronësisë, që do të thotë se të drejtat dhe interesat e tij janë objekt i atij gjykimi.

### *Vendimarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, njëzëri, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

**FJALË KYÇE**  
*Përgjegjësi personale e  
magjistratit/ procedim  
disiplinor/ komision i  
posaçëm*

# VENDIME TË MBLEDHJES SË GJYQTARËVE PËR ANKIMIN KUSHTETUES INDIVIDUAL

**Zbatimi i detyrueshëm  
i vendimeve të  
Gjykatës Kushtetuese -  
E drejta e aksesit –  
Standardi i arsytimit  
të vendimit gjyqësor**

## ***Rrajmond Toptani (kthimi për rigjykim i çështjes nga Gjykata Kushtetuese) - vendim nr. 37, datë 28.02.2024***

### *Faktet*

Kërkuesi është trashëgimtar ligjor i subjekteve të shpronësuara të cilët kanë përfituar një pasuri nga martesat e dytë e babait të tyre. Vendimi i KKKP-së që i ka njohur këtë pronë kërkuesit është kundërshtuar në gjykatë nga njëri prej trashëgimtarëve nga martesat e parë e trashëgimlënësit, që ka paraqitur si provë një vendim gjyqësor që deklaronte të pavlefshme shitjet e këtij të fundit për gruan nga martesat e dytë. Gjykata ka vendosur pranimin e padisë. Në vijim, pasi kjo provë është shpallur e falsifikuar, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë për rishikimin e vendimit të formës së prerë Gjykatës së Lartë, e cila ka vendosur mospranimin. Pasi ka ardhur në dijeni të disa provave të tjera, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim, e cila ka vendosur sërish mospranimin. Ky vendim është kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese, e cila në vitin 2014 ka vendosur shfuqizimin dhe ridërgimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. Në vitin 2015, Gjykata e Lartë ka vendosur përsëri mospranimin e kërkesës për rishikim, vendim i cili është shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2017. Në rigjykim Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim.

### *Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve*

*Standardi i zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës i lidhur me të drejtën e aksesit dhe standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* – Gjykata Kushtetuese ka vendosur dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë në vitin 2017 për shkak se çështja duhej të ishte shqyrtuar në seancë gjyqësore, në mënyrë që të bëhej analizimi në thelb i shkaqeve të rishikimit. Megjithatë pas ndryshimeve në legjislacionin procedural civil ka ndryshuar kompetenca e dhomës së këshillimit, e cila mund të shqyrtojë kërkesën për rishikim pa praninë e palëve mbi bazë të akteve. Ky gjykim nuk është vetëm një konstatim formal i shkaqeve ligjore të paraqitura në kërkesën e rishikimit, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërinë e tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë ka njoftuar palët në mënyrë të drejtpërdrejtë duke u dhënë mundësinë e paraqitjes së parashtrimeve të tyre dhe duke siguruar të drejtën e aksesit. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë përmbush standardin e arsytimit të vendimit.

### *Vendimmarrja*

Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi, njëzëri, moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

**FJALË KYÇE**  
***Kërkesë për rishikim /  
kthim për rigjykim në  
Gjykatën e Lartë / gjykim  
në dhomë këshillimi***